



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2783/8 prot

Datë 06.12.2023

**V E N D I M**

**Nr. 1269/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.12.2023, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-86052-11-01-2023, me objekt: “*Shërbim Netëorku për Trasmetimin e të Dhënave midis Zyrës Qendrore dhe Zyrave në Rrethe*”, me fond limit 98,201,100 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, “IdentiTek” SHA.
- Autoriteti Kontraktor:** “IdentiTek” SHA, me adresë: Rruga “Xhanfize Keko”, Ish Topografia Ushtarake, Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Albanian Satellite Communications” SHPK me NUIS K62115018I, me adresë: Rruga e Qelqit, Kombinat, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave*”

*Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 02.11.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-86052-11-01-2023, me objekt: “Shërbim Netëorku për Trasmetimin e të Dhënave midis Zyrës Qendrore dhe Zyrave në Rrethe”, me fond limit 98,201,100 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, “Identitek” SHA.

II.2. Në datën 10.11.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është administruar ankimi me nr. 2783 protokolli, e operatorit ekonomik “Albanian Satellite Communications” SHPK, nëpërmjet të cilit është kërkuar modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Konkretisht pretendohet si vijon:

***1.Është kërkuar linjë backup 4G si më poshtë:***

*Lidhje e Dedikuar Back up 4G/LTE qe vijon te njejtin vlan Sherbim Data*

- *Terminimi ne Zyrat e aplikimit te behet me:*
  - *4GE/LTE SFP Router Sëitch dhe duhet te mundesohen nga Ofruesi*
  - *Konfigurimi duhet te jete Ean redundant me Primar Fiber Optic / Backup Sim GSM me Vlan te dedikuar sherbim data*

Ky kriter është përjashtues për të gjitha kompanitë, pasi dihet publikisht që vetëm dy kompani janë të licencuara për këtë lloj shërbimi. Ju bëjmë me dije se kemi 10 vite që ofrojmë shërbimin e komunikimit të zyrave të ALEAT sot Itentitek, dhe shërbimi është ofruar nëpërmjet fibrës optike dhe lidhjeve satelitore, ku shërbimi terminohet brenda Shqipërisë, pasi dhe HUB Satelitor është instaluar në ambientet e Albanian Satellite Communications, si dhe disponojmë dhe autorizim të posacëm nga AKEP për ofrimin e këtij shërbimi.

Referuar dhe negociimit të kryer për këtë shërbim, i referohemi shërbimit satelitor, ndërsa në procedurën e re kërkohet karta sim 4G.

Ky kriter duhet të ndryshohet nga Karta sim 4G në linjë satelitore.

**2.Lidhur me ruterat të cilët kërkoni të ofrohet shërbimi, janë të një marke të vetme, të cilët cojnë në të drejtë eskuzive dhe paracakton fituesin e kësaj procedure si më poshtë:**

**Kritere Funktionale per Ofruesin e Sherbimit :**

- Te mundesoje Platforme Menaxhimi dhe Sistem Kontrolli te qendersuar per Routerat e zyrave te aplikimit
- Te plotesoje kerkesat e reja per Sherbim Data per Zyrat Aplikimit
- Te garantoje kerkesat per relokim te zyrave egzistuese apo dhe te reja te aplikimit
- Te garantoje stokun e mjaftueshem me routera per gjate gjithe vlefshmerise se sherbimit.
- Te gjithë routerat te jete te te njejtit vendor dhe te jene te certifikuar dhe me specifikimet teknike si me poshte :

**Certifikim**

Health EN 62311 Safety EN 60950 - 1+A11+A1+A12 EN 301-489-1/-7/-17/-24 EN 55022,

EN 55024 EN 301 511 EN 301 908-1/-2 EN 300 328 EMC Radio

Ethernet Standard	<p>IEEE 802.3</p> <p>IEEE 802.3u</p> <p>AP, Client, Bridge Mode Support</p> <p>ËEP, ËPA and ËPA2 encryption ëith AES-TKIP</p> <p>IEEE 802.11ac Optional 5GHz Ëi-Fi support</p> <p>SSID Insulation Support</p> <p>Channel management support</p> <p>20MHz / 40MHz /80MHz Beamer support</p>
-------------------	--

<i>Status Indications</i>	<p><i>SFP: Status Indicator</i></p> <p><i>NET: Connection Setup</i></p> <p><i>ËLAN: Ëireless LAN Connection</i></p> <p><i>ËAN: Ëide Area Netëork Cable Connection Status</i></p> <p><i>LAN: Local Area Cable Connection Status (Lan1 ~ Lan4)</i></p> <p><i>POËER: Poëer Status</i></p> <p><i>VPN: Connection Status Indicator</i></p> <p><i>ËPS: Clear Ëifi Connectivity Indicator</i></p> <p><i>VoIP: IP phone connection indicator</i></p>
<i>Cellular Specifications</i>	<p><i>LTE 800/900/1800/2100/2600 MHz</i></p> <p><i>UMTS/HSPA+900/2100MHz</i></p> <p><i>GSM/GPRS 900/1800/1900 MHz</i></p> <p><i>HSPA+/HSUPA/HSDPA/ËCDMA/UMTS 2100/1900/900/850/800MHz</i></p> <p><i>EDGE/GPRS/GSM 1900/1800/900/850 MHz</i></p> <p><i>HSUPA/HSDPA/UMTS 2100/1900/900/850 MHz</i></p> <p><i>EDGE/GPRS/GSM 1900/1800/900/850 MHz</i></p> <p><i>CDMA 2000/EVDO Rev.A 800MHz</i></p> <p><i>SINGLE SIM/SINGLE GSM MODULE (1x IMEI)</i></p>
<i>Interfaces</i>	<p><i>Minimalisht ose me shume 4x10 / 100/1000 Mb LAN Port</i></p> <p><i>1x10 / 100/1000 Mb ËAN Port</i></p> <p><i>1x10 / 100/1000 Mb SFP Port</i></p> <p><i>1xStandard DC Poëer Input Port</i></p> <p><i>1xUSB Input Port</i></p>
<i>Others</i>	<p><i>Operating Temperature: 0 °C - 40 °C</i></p> <p><i>Dimension: 240mm x 150mm x 35mm ëight: 392gr.</i></p>

	<i>Specifikimet Funktionale</i>
--	---------------------------------

<i>Firewall &amp; Filtering</i>	<i>IP packet / Domain / MAC Filter</i> <i>NAT</i> <i>DMZ</i> <i>Protocol Type Check</i> <i>Port Control</i> <i>VLAN Tagging</i>
<i>VPN</i>	<i>IPsec</i> <i>PPTP server</i> <i>L2TP server</i>
<i>Routing</i>	<i>Static Routing, Regulatory Routing, Port Routing</i> <i>RIPv2 / OSPF Dynamic Routing</i>
<i>Poëer Supply</i>	<i>9 ~24VDC</i>
<i>Management</i>	<i>Wëb Broëser ( local / remote) (IE v8 or above)</i> <i>CLI/Telnet M2M</i> <i>Management</i> <i>SSH</i>
<i>Data Features</i>	<i>QoS: Speed limitation, packet prioritization</i> <i>IPv4 / IPv6, TCP / IP, UDP, RTP, SNTP, NAT, DNS, DDNS</i> <i>Address management: Static, DHCP Server, IP / MAC</i> <i>connector, DHCP siëtching</i>
<i>Poëer Consumption</i>	<i>Idle: 12V / 1A</i> <i>Single Module Poëer Consumption: &lt;5W</i>
	<i>Opsionet e Pajisjes</i>
<i>Multiple Wëorking Modes</i>	<i>Led monitor</i> <i>WëEB, CLI, SSH, multi-parameter management support</i> <i>Data trigger online/offline</i> <i>LCP/ICMP/floë/availability signal control, netwëork</i> <i>availability</i>

<p><i>Easy Maintenance Operation</i></p>	<p><i>Local/remote firmëare and patch upgrade support</i></p> <p><i>Parameter backup and retrieval support, encryption support</i></p> <p><i>CFE firmëare update support</i></p> <p><i>Smart sëitch support ëhen using multiple servers</i></p> <p><i>Local/remote system logging for easy debugging</i></p>
<p><i>Full Netëork Mode</i></p>	<p><i>ËAN, ËLAN</i></p> <p><i>ËLAN AP/Station/Repeater, 802.11n 2.4GHz up to 300 Mbps 4 LAN ports,</i></p> <p><i>Support Fiber SFP</i></p> <p><i>ËAN support ADSL (PPPoE), static IP, DHCP client</i></p> <p><i>802.11b/g/n optional Ëi-Fi, ËPS sëitch</i></p> <p><i>DNS proxy and Dynamic DNS (DDNS) support</i></p>

*Table 2 Specifikimet Teknike per Routerat e Zyrave te Aplikimit*

*Albanian Satellite Communications ka mbi 15 vite që ofron shërbime ndërlidhje interneti dhe data për institucione të ndryshme shtetërore. Në të gjitha procedurat pjesëmarrëse kërkesat teknike janë për llojin e shërbimit që kërkohet dhe jo për kompani të vecanta që tregtojnë routera. Ky shërbim mund të ofrohet dhe nga routera të tjerë dhe me specifikime ndoshta dhe më të mira se ato që janë vendosur.*

*Ky kriter duhet të hiqet pasi janë specifikimet e një marke të caktuar.*

**3. Në kërkesat teknike është kërkuar:**

- ***Ofruesi duhet të marri shërbimin nga minimalisht 2 ISP Tier 1***
- ***Ofruesi duhet të jete minimalisht Tier 2***

*Ky kriter nuk është aplikuar në asnjë procedurë prokuruese për shërbim interneti dhe data deri me sot.*

*AK duhet të referohet tek KVK e AKSHI si Agjenci e vetme shtetërore që ofron shërbime dhe prokuron për të gjitha institucionet shtetërore.*

*Në procedura analoge AKSHI ka kërkuar:*

1. *Numri aktual “Peer” që operatori duhet të disponojë si Uplink për daljen e tij në internet nuk duhet të jetë më i vogël se 5, ku nga këto 5 duhet të ketë të paktën 2 “Peers” me provider AS të regjistruar jashtë territorit të Shqipërisë. Shërbimi me secilin prej 5 operatorëve duhet të dëshmohet me anë të kontratës përkatëse si edhe të jetë i verifikueshëm nëpërmjet Databazës së “RIPE NCC”.*

*Kërkojmë që ky kriter të zëvendësohet sipas versionit të AKSHI-t.*

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datën 20.11.2023, është protokolluar në KPP me nr. 2783/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 449/11 prot., datë 16.11.2023, me objekt: “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim Netëorku për Transmetimin e të Dhënave midis Zyrës Qendrore dhe Zyrave në Rrethe”, bashkëngjitur saj shkresa me nr. 449/10 prot., datë 15.11.2023 me objekt: “Dërgohet vendimi mbi ankesën”, drejtuar shoqërisë “Albanian Satellite Communications” SHPK, për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, me vendimin e KSHA lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.5. Referuar shkresës me nr. 449/10 prot., datë 15.11.2023 të autoritetit kontraktor rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Albanian Satellite Communications” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur mospranimin e ankesës, me argumentat e mëposhtme:

*“[...] Fillimisht ju bëjmë me dije se statuti dhe objekti i veprimtarisë së IdentiTek SHA ndryshon shumë nga statuti dhe objekti i veprimtarisë së ALEAT SHPK dhe pse në pamje të parë objekti kryesor është: “... kryerja e shërbimit kundrejt pagesës, të prodhimit dhe shpërndarjes së: a) letërnjoftimit elektronik dhe pasaportës biometrike (të zakonshme, të shërbimit dhe diplomatik/ .. Infrastruktura e Rrjetit Kompjuterik dhe Sigurisë Informatike të IdentiTek SHA është kategorizuar dhe klasifikuar si OIKI “Operator i Infrastrukturës Kritike të Informacionit” nga ana e Akcesk. Si rrjedhojë autoritetit kontraktor i linden të drejta dhe detyrime për të përmbushur bazuar në standardet dhe rekomandimet e tij.*

*Në vazhdim të objektivave dhe standardeve ndërkombëtare ISO/IEC JTC 1/SC 27 për mbrojtjen e seteve të informacionit elektronik dhe TIK, kjo përfshin metoda, teknika dhe udhëzime të përgjithshme për të trajtuar aspektet e sigurisë dhe rrjetit kompjuterik si më poshtë:*

- *Menaxhimi i sigurisë së informacionit dhe TIK; në vecanti sistemet e menaxhimit të rrjetit kompjuterik dhe sigurisë së informacionit , proceset e sigurisë dhe kontrollet dhe shërbimet e sigurisë;*
- *Mekanizmat kriptografikë dhe mekanizma të tjerë të sigurisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në mekanizmat për mbrojtjen e llogaridhënies, disponueshmërisë, integritetit dhe konfidencialitetit të informacionit;*
- *Aspektet e sigurisë të menaxhimit të identitetit dhe biometrisë;*
- *Kërkesat e vlerësimit të konformitetit, akreditimit dhe auditimit në fushën e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit;*
- *Kriteret dhe metodologjia e vlerësimit të sigurisë.*

*Bazuar në kërkesat për protokolle komunikimi të sigurt dhe të ndërveprueshme për rrjetet fikse, mobile dhe satelitore të pajisjeve dhe shërbimeve të shpërndara në distancë që mund të mbështeten gjithashtu në burime dhe ndërfaqe me menaxhim të qendërsuar. Ku kërkesat*

*duhet të lejojnë dhe plotësojnë mekanizmat përkatës të komunikimit, vërtetimit, regjistrimit dhe përpunimit të identitetit në mënyrë të përsosur nëpër pajisje rrjeti kompjuterik (routera) dhe sisteme të përpunimit të informacionit, ku prodhohet, personalizohet dhe dorëzohet letërnjoftimi elektronik dh epasaporta biometrike për shtetasit shqiptare. [...]*

*Pretendimi nr.1*

*OE pretendon se ka njohuri në shërbimin e kërkuar nga kontrata e mëparshme që ka patur me Aleat SHPK.*

*AK përgjigje: Sikurse në vazhdimësi IdentiTek ka lidhur një kontratë të ngjashme afatshkurtër për të njëjtin shërbim në kushte të forcuara në mënyrë që të garantojë vazhdimësinë e shërbimit për prodhimin e letërnjoftimit elektronik dhe pasaportës biometrike, por që vazhdon të jetë në mos përmbushjen e standardeve dhe rekomandimeve të Akcesk.*

*Pretendimi nr.2*

*OE pretendon: se në kërkesat teknike me shumë rëndësi i është dhënë routerave se sa vetë shërbimit të komunikimit.*

*AK përgjigje: kjo është bërë për të vetmen arsye sepse pajisjet (routerat) janë aktorët kryesorë që duhet të lejojnë dhe plotësojnë funksionet përkatës të komunikimit, vërtetimit, procesimit të regjistrimit dhe përpunimit të identitetit në mënyrë të përsosur.*

*Vlen të theksohet se këto janë kërkesa minimale dhe cdo gjë tjetër mbi to është e pranueshme.*

*Pretendimi nr.3*

*OE pretendon: se është hequr shërbimi satelitor si mundësi ofrimi shërbimi primar ose backup si dhe është vendosur shërbim telefonie celulare për ofrimin e shërbimit të internetit. Dhe që janë vendosur kritere që i përkasin një prodhuesi të caktuar.*

*AK përgjigje: Po është hequr shërbimi satelitor në kuadër të përmirësimit të cilësisë së shërbimit, gjatë 3 mujorit të fundit janë hasur shumë problematika në lidhje me zyrat e aplikimit kryesisht në rrethe dhe që janë me shërbim satelito. Nga ana e grupit të punës u bë një vlerësim i teknologjisë satelitore dhe teknologjisë 4G si më poshtë:*

<i>Karakteristika</i>	<i>Fiber Optike</i>	<i>Teknologjia 4G</i>	<i>Teknologjia Satelitore</i>
<i>Shpejtësia</i>	<i>Ok</i>	<i>Ok</i>	<i>X</i>
<i>Vonesa</i>	<i>Ok</i>	<i>Ok</i>	<i>X</i>
<i>Faktori Atmosferik</i>	<i>Nuk ndikon</i>	<i>Ndikon</i>	<i>Ndikon</i>
<i>Disponueshmëria</i>	<i>Ok</i>	<i>Ok</i>	<i>Ok</i>
<i>Besueshmëria</i>	<i>Ok</i>	<i>Ok</i>	<i>X</i>
<i>Stabiliteti</i>	<i>Ok</i>	<i>Ok</i>	<i>X</i>

*Shënim: OK- plotëson pritshmëritë e autoritetit, X-nuk plotëson pritshmëritë e autoritetit.*

*Rezultantja: Teknologjia 4G e përmbush brezin e gjerë të pritshmërive për faktor dhe për këtë arsye është vendosur si BACKUP, ndërsa teknologjia satelitore përmbush vetëm faktorin e disponueshmërisë dhe për këtë arsye nuk u konsiderua.*



AK përgjigje: Për rastin e linje primare kërkohet që OE të zotërojë infrastrukturën e transmetimit, ndërsa për linjën back up nuk shtë e detyrueshme të zotërohet nga OE, ai mund ta sigurojë atë nëpërmjet ofertuesve të tjerë. Në rastin tonë bëhet fjalë për shërbimin e transmetimit të të dhënave nga ana e zyrave qendrore dhe zyrave në rrethe, kështu që pohimi se “janë vendosur kritere që i përkasin një prodhuesi të caktuar” është i pavlefshëm. Shërbimi i kërkuar është i kompozuar dhe i ndërlidhur me thyerje teknologjie për të arritur maksimumin e të dy faktorëve teknologjikë për të siguruar të njëjtën cilësi shërbimi të përsosur dhe OE mund ta sigurojë atë përmes ofertuesve të tjerë në treg. Nqs nuk do konsiderohej si kriter cilësia e shërbimit dhe do të vendosim si back up transmetimin satelitor do të siguronim avantazh dhe kritere drejt një provideri të caktuar me konkretisht drejt OE i cili ka depozituar ankesë.

Këto të dhëna faktore janë të njohur botërisht. Për këtë arsye grupi i punës futi në studim tregu teknologjinë 4G dhe të gjithë OE që kanë ofertuar e kanë përfshirë në zgjidhjen teknike të ofruar pa komente apo mangësi.

#### Pretendimi nr.4

OE pretendon se janë vendosur kritere tir 1 dhe tir 2 që nuk janë hasur në asnjë procedurë tjetër prokuruese sidomos në shërbim kaq kritik sic është prodhimi i pasaportave dhe karta ID.

AK përgjigje: Në industrinë e Ofruesve të Shërbimeve të Interneitt (ISP), TERMAT “Tier-1”, “Tier-2” dhe “Tier-3” përdoren për të klasifikuar ISP-të, bazuar në nivelin e shërbimit që ofrojnë dhe infrastrukturën që ata përdorin.

ISP-të e nivelit 1 ose Tier1 janë ISP-të më të mëdhenj dhe më të rëndësishëm në infrastrukturën globale të internetit. Ata janë përgjegjës për sigurimin e bazës së internetit dhe lidhjen e ISP-ve të tjera me internetin global. ISP-të e nivelit 1 zakonisht nuk ofrojnë shërbime drejtpërdrejt për përdoruesit fundorë, por më tepër shesin gjerësinë e brezit dhe kapacitet me sasi tek ISP-të e tjera.

ISP-të e nivelit 2 ose Tier 2 janë më të vegjël se ISP-të e nivelit 1 dhe zakonisht janë ofrues rajonalë ose kombëtarë që i shërbejnë një zonë specifike gjeografike. Ata mund të blejnë gjerësi brezi me sasi nga ISP-të e nivelit 1 dhe túa rishesin atë isp-VE TË TJERË OSE Institucioneve Qeveritare apo të rëndësisë së vecantë ose kompanive të mëdha.

ISP-të e nivelit 3 ose Tier 3 janë më të vegjël se ISP-të e nivelit 2 dhe zakonisht janë ofrues lokalë që i shërbejnë një komuniteti ose zone specifike lokale. Ata mund të blejnë gjerësi brezi me sasi nga ISP-të e nivelit 2 dhe túa rishesin atë përdoruesve fundorë ose mund t’u ofrojnë shërbime drejtpërdrejtë përdoruesve fundorë.

Bazuarn këto standarde të cilat janë të njohur botërisht, grupi i punës futi nëstudim tregu Tier 1 dhe Tier 2 ISP, për të garantuar shërbimin kritik kundrejt institucioneve qeveritare apo të rëndësisë së vecantë si është dhe autoriteti kontraktor.

#### Pretendimi nr.5

OE pretendon se: Routerat e kërkuar janë të një marke të vetme, të cilët cojnë në të drejtë eskuzive dhe paracakton fituesin.

AK përgjigjet: Natyra e kërkesës është si shërbim dhe jo si blerje paisjes. Specifikimet teknike për routera janë venosur për të garantuar shërbim të përsosur dhe janë kërkuar të një brandi

*të vetëm për të unifikuar teknologjinë. Në këtë formë AK trajnon stafin për një teknologji të caktuar dhe është me eficente në raport me kostot. Specifikimet teknike janë të natyrës minimale dhe cdo gjë tjetër mbi to është e pranueshme. Pretendimet e OE janë të pabazuara [...].”*

II.6. Në datën 01.12.2023, nëpërmjet shkresës me nr. 2783/4 prot., me objekt: “Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe nenit 23 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoi të nevojshëm zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 05.12.2023, ora 13:00, në ambientet e institucionit të KPP-së, me përfaqësues të operatorit ekonomik ankimues “Albanian Satellite Communications” SHPK dhe përfaqësues së autoritetit kontraktor “Identitek” SHA.

II.7. Në datën 05.12.2023, në prani të përfaqësuesve të shoqërisë “Albanian Satellite Communications” SHPK, të autoritetit kontraktor “Identitek” SHA dhe të Komisionit të Prokurimit Publik, në ambientet e KPP-së u mbajt një seancë dëgjimore me regjistrim audio të seancës. Në këtë seancë përfaqësuesit e autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, dhanë argumentet e tyre lidhur me pretendimet e ngritura. Në seancën dëgjimore, Komisioni ngriti pyetjet për autoritetin kontraktor dhe operatorin ekonomik ankimues, të cilët dhanë argumentet e tyre, lidhur me pyetjet e ngritura në këtë seancë.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik,**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Albanian Satellite Communications” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE, rezulton ,se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si vijon:

#### **Shtojca 5.**

*[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]*

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

## 1. Përshkrimi konceptual dhe funksional I zgjidhjes qe Operatori duhet te ofroje:

### 1.1. Sherbim Interneti per Zyren Qendrore

### 1.2. Sherbim Data per Zyrat e Aplikimit

Me poshte paraqitet nje skeme Konceptuale e zgjidhjes shume funksionale




Figure 1 Skema konceptuale e zgjidhjes shume funksionale

## 2. Përshkrimi Funksional I zgjidhjes qe Operatori duhet te ofroje:

### a. Sherbim Interneti per Zyren Qendrore

#### **Linje e Dedikuar e Internetit ne Zyren Qendrore**

Identitek kërkon shërbim interneti të dedikuar dhe me kapacitet Donëload dhe Upload Simetrik 300 Mbps / 300 Mbps, me CIR 99,5 %. Linja do të jetë e dedikuar vetëm për klientin dhe do të jetë në monitorim nga Sistemet të Menaxhimit të Rrjetit, duke siguruar nje cilesi sherbimi SLA (Service Level Agreement) dhe mbështetje proaktive në rast degradimi apo defektesh.

Për të mundësuar lidhjen ofruesi do të sigurojë lidhjen midis Identitek dhe rrjetit të tij duke përdorur teknologjinë e fibrave optike. Lidhja do të mbrohet, duke krijuar lidhje nga dy pika të ndryshme prezence (PoP).

Të dyja lidhjet do të realizohen nga pika në pikë nga pika e pranisë së ofruesit në ambientet e Identitek por ne drejtime te ndryshme duke garantuar keshtu disponueshmerine ne rast defektesh apo demtimesh fizike. Lidhja e parë do të qëndrojë aktive gjatë gjithë kohës dhe në rast problemesh lidhja e dyte do të kalojë në linjë aktive. Kalimi nga linja aktive në linjën e gatishmërisë do të bëhet në mënyrë automatike duke përdorur pajisjen sëitch inteligjent te menaxhueshem të operatorit.

Kriteret Teknike per sherbimin e Internetit ne zyrat qendrore :

- Lidhje e Dedikuar me Fiber Optike Dual Path Redundant deri ne Rack Kabinet
- Terminimi ne Zyrat Qendrore te Identitek dhe Tek Zyrat e Ofruesit duhet te behet me :

o Sëitch Gigabit Layer 2 Inteligent dhe te menaxhueshem me Porte SFP dhe Modul SFP, te te njetit vendor dhe tekonolgi dhe duhet te mundesohen nga

Ofruesi o Sëitch duhet te suportojë layer 2 encryption mundsisht me kapacitet

Gigabit o Konfigurimi duhet te jete me Vlan te dedikuar

- Class IP Publike Reale me kapacitet X.X.X.X/26
- Kapacitet Simetrik Donëload dhe Upload Minimalisht 300 Mbps / 300 Mbps, dhe me disponueshmeri CIR 99,5 %.
- Ofruesi duhet te marri sherbimin nga minimalisht 2 ISP Tier 1
- Ofruesi duhet te jete minimalisht Tier 2

b. Sherbim Data per Zyrat e Aplikimit

### **Linje e Dedikuar sherbim Data ne Zyrat e Aplikimit**

Ofruesi ne po te njejten linje te dedikuar me zyren qendrore duhet të ofrojë një zgjidhje Sherbim Data dhe te mundesoje neprmjete rrjetit te tij me cilësi të lartë dhe akses me zgjerueshmeri të mjaftueshme për të gjithë Zyrat aktuale te Aplikimit por edhe per ato zyrat qe do te mund te shtohen ne te ardhmen dhe pavarësisht vendodhjes, duke garantuar komunikim dhe sherbim data me Zyren Qendrore te Identitek.

Me poshte po ju paraqesim tabelen me Zyrat aktuale te Aplikimit :

<b>Nr.</b>	<b>Zyrat e Aplikimit te Identitek</b>	<b>Kodi Unik</b>	<b>Qyteti</b>	<b>Komuna</b>	<b>Sherbi m Data</b>
1	Tirana-1-Neë-Site		Tirane	Tirane	
2	Tirana-2-Neë-Site		Tirane	Tirane	
3	Tirana-3		Tirane	Tirane	
4	Tirana-4		Tirane	Tirane	
5	Tirana-5-Neë-Site		Tirane	Tirane	
6	Tirana-6		Tirane	Tirane	
7	Tirana-7-Neë-Site		Tirane	Tirane	
8	Tirana-8-9-Neë-Site		Tirane	Tirane	
9	Tirana-10		Tirane	Tirane	
10	Tirana-11-Neë-Site		Tirane	Tirane	
11	Tirana-12 – Fresku		Tirane	Tirane	

12	<i>Tirana-13 - K. Diellit</i>		<i>Tirane</i>	<i>Tirane</i>	
13	<i>Tirana-14 - Unaze e Re</i>		<i>Tirane</i>	<i>Tirane</i>	
14	<i>Bashkia Kamez</i>		<i>Tirane</i>	<i>Tirane</i>	
15	<i>Komuna Farke</i>		<i>Tirane</i>	<i>Tirane</i>	
16	<i>Bashkia Vore</i>		<i>Tirane</i>	<i>Tirane</i>	
17	<i>Bathore</i>		<i>Tirane</i>	<i>Tirane</i>	
18	<i>IDENTITEK-DVKM-TIRANELAPRAKE</i>		<i>Tirane</i>	<i>Tirane</i>	
19	<i>Bashkia Durres R 1</i>		<i>Durres</i>	<i>Durres</i>	
20	<i>Bashkia Durres R 2</i>		<i>Durres</i>	<i>Durres</i>	
21	<i>Bashkia Durres R 3</i>		<i>Durres</i>	<i>Durres</i>	
22	<i>Bashkia Durres R 4</i>		<i>Durres</i>	<i>Durres</i>	
23	<i>Bashkia Durres R 5</i>		<i>Durres</i>	<i>Durres</i>	
24	<i>Bashkia Durres R 6</i>		<i>Durres</i>	<i>Durres</i>	
25	<i>Komuna Xhafzotaj</i>		<i>Durres</i>	<i>Durres</i>	
26	<i>Elbasan No.1</i>		<i>Elbasan</i>	<i>Elbasan</i>	
27	<i>Elbasan No 2</i>		<i>Elbasan</i>	<i>Elbasan</i>	
28	<i>Elbasan No.3</i>		<i>Elbasan</i>	<i>Elbasan</i>	
29	<i>Elbasan No.4</i>		<i>Elbasan</i>	<i>Elbasan</i>	
30	<i>Elbasan No.5</i>		<i>Elbasan</i>	<i>Elbasan</i>	
31	<i>Fier No.1</i>		<i>Fier</i>	<i>Fier</i>	
32	<i>Fier No.2</i>		<i>Fier</i>	<i>Fier</i>	
33	<i>Fier No.3</i>		<i>Fier</i>	<i>Fier</i>	
34	<i>Fier No.4</i>		<i>Fier</i>	<i>Fier</i>	
35	<i>Patos</i>		<i>Fier</i>	<i>Patos</i>	
36	<i>Bashkia Roskovec</i>		<i>Fier</i>	<i>Roskovec</i>	
37	<i>Korce No.1</i>		<i>Korce</i>	<i>Korce</i>	
38	<i>Korce No.2</i>		<i>Korce</i>	<i>Korce</i>	
39	<i>Korce No.3</i>		<i>Korce</i>	<i>Korce</i>	
40	<i>Korce No.4</i>		<i>Korce</i>	<i>Korce</i>	
41	<i>Bashkia Maliq</i>		<i>Korce</i>	<i>Maliq</i>	
42	<i>Bashkia Lezhe</i>		<i>Lezhe</i>	<i>Lezhe</i>	
43	<i>Lushnje Rajoni No.1</i>		<i>Fier</i>	<i>Lushnje</i>	

44	<i>Lushnje Rajoni No.2</i>		<i>Fier</i>	<i>Lushnje</i>	
45	<i>Bashkia Koplík, Malesi e Madhe</i>		<i>Malesi e Madhe</i>	<i>Koplík</i>	
46	<i>Vlore No.1</i>		<i>Vlore</i>	<i>Vlore</i>	
47	<i>Vlore No.2</i>		<i>Vlore</i>	<i>Vlore</i>	
48	<i>Vlore No.3</i>		<i>Vlore</i>	<i>Vlore</i>	
49	<i>Vlore No.4</i>		<i>Vlore</i>	<i>Vlore</i>	
50	<i>Vlore No.5</i>		<i>Vlore</i>	<i>Vlore</i>	
51	<i>Bashkia Oriku</i>		<i>Vlore</i>	<i>Oriku</i>	
52	<i>Bashkia Librazhd</i>		<i>Librazhd</i>	<i>Librazhd</i>	
53	<i>Bashkia Krume, Has</i>		<i>Has</i>	<i>Krume</i>	
54	<i>Bashkia B. Curri, Tropoje</i>		<i>Bajram Curri</i>	<i>Bajram Curri</i>	
55	<i>Bashkia Lac</i>		<i>Shkoder</i>	<i>Lac</i>	
56	<i>Policia Durres</i>		<i>Durres</i>	<i>Durres</i>	
57	<i>Policia Fier</i>		<i>Fier</i>	<i>Fier</i>	
58	<i>Policia Lezhe</i>		<i>Lezhe</i>	<i>Lezhe</i>	
59	<i>Policia Tirana (Drejtoria Policise)</i>		<i>Tirane</i>	<i>Tirane</i>	
60	<i>Shkoder No.1</i>		<i>Shkoder</i>	<i>Shkoder</i>	
61	<i>Shkoder No.2</i>		<i>Shkoder</i>	<i>Shkoder</i>	
62	<i>Shkoder No.3</i>		<i>Shkoder</i>	<i>Shkoder</i>	
63	<i>Shkoder No.4</i>		<i>Shkoder</i>	<i>Shkoder</i>	
64	<i>Bashkia Permet</i>		<i>Permet</i>	<i>Permet</i>	
65	<i>Policia Permet</i>		<i>Permet</i>	<i>Permet</i>	
66	<i>Bashkia Sukth</i>		<i>Durres</i>	<i>Sukth</i>	
67	<i>Policia Lac</i>		<i>Lezhe</i>	<i>Lac</i>	
68	<i>Policia Gjirokaster</i>		<i>Gjirokaster</i>	<i>Gjirokaster</i>	
69	<i>Bashkia Kukes</i>		<i>Kukes</i>	<i>Kukes</i>	
70	<i>Bashkia Sarande</i>		<i>Sarande</i>	<i>Sarande</i>	
71	<i>Mbrostar</i>		<i>Fier</i>	<i>Fier</i>	
72	<i>Policia Vlore</i>		<i>Vlore</i>	<i>Vlore</i>	
73	<i>Policia Shkoder</i>		<i>Shkoder</i>	<i>Shkoder</i>	
74	<i>Komuna Paskuqan</i>		<i>Tirane</i>	<i>Tirane</i>	

75	<i>Bashkia Fushe Kruje</i>		<i>Tirane</i>	<i>Tirane</i>	
76	<i>Bashkia Cerrik</i>		<i>Elbasan</i>	<i>Cerrik</i>	
77	<i>Bashkia Belsh</i>		<i>Elbasan</i>	<i>Belsh</i>	
78	<i>Bashkia Gramsh</i>		<i>Elbasan</i>	<i>Gramsh</i>	

79	<i>BASHKIA BERAT No.1</i>		<i>Tirane</i>	<i>Tirane</i>	
80	<i>BASHKIA BERAT No.2</i>		<i>Tirane</i>	<i>Tirane</i>	
81	<i>BASHKIA BERAT No.3+4</i>		<i>Tirane</i>	<i>Tirane</i>	
82	<i>Bashkia Ura Vajgurore</i>		<i>Tirane</i>	<i>Tirane</i>	
83	<i>Bashkia Polican</i>		<i>Tirane</i>	<i>Tirane</i>	
84	<i>Bashkia Divjake</i>		<i>Lushnje</i>	<i>Lushnje</i>	
85	<i>Bashkia Vau Dejes</i>		<i>Shkoder</i>	<i>Shkoder</i>	
86	<i>Bashkia Puke</i>		<i>Shkoder</i>	<i>Shkoder</i>	
87	<i>Bashkia Himare</i>		<i>Vlore</i>	<i>Himare</i>	
88	<i>Komuna Novosele</i>		<i>Vlore</i>	<i>Novosele</i>	
89	<i>Bashkia Delvine</i>		<i>Vlore</i>	<i>Delvine</i>	
90	<i>Bashkia Burrel</i>		<i>Diber</i>	<i>Burrel</i>	
91	<i>Bashkia Peshkopi</i>		<i>Diber</i>	<i>Peshkopi</i>	
92	<i>Bashkia Klos</i>		<i>Diber</i>	<i>Klos</i>	
93	<i>Bashkia Bulqize</i>		<i>Diber</i>	<i>Bulqize</i>	
94	<i>Bashkia Prrenjas</i>		<i>Elbasan</i>	<i>Perrenjas</i>	
95	<i>Bashkia Mamurras</i>		<i>Kurbin</i>	<i>Mamurras</i>	
96	<i>Bashkia Rrogozhine</i>		<i>Kavaje</i>	<i>Rrogozhine</i>	
97	<i>Bashkia Kavaje</i>		<i>Kavaje</i>	<i>Kavaje</i>	
98	<i>Policia Berat</i>		<i>Berat</i>	<i>Berat</i>	
99	<i>Policia Corovode</i>		<i>Berat</i>	<i>Corovode</i>	
100	<i>Policia Peshkopi</i>		<i>Diber</i>	<i>Peshkopi</i>	
101	<i>Policia Burrel</i>		<i>Diber</i>	<i>Burrel</i>	
102	<i>Policia Elbasan</i>		<i>Elbasan</i>	<i>Elbasan</i>	
103	<i>Policia Gramsh</i>		<i>Gramsh</i>	<i>Gramsh</i>	
104	<i>Policia Librazhd</i>		<i>Librazhd</i>	<i>Librazhd</i>	

10 5	<i>Policia Lushnje</i>		<i>Fier</i>	<i>Lushnje</i>	
10 6	<i>Policia Korce</i>		<i>Korce</i>	<i>Korce</i>	
10 7	<i>Policia Pogradec</i>		<i>Pogradec</i>	<i>Pogradec</i>	
10 8	<i>Policia Kukes</i>		<i>Kukes</i>	<i>Kukes</i>	
10 9	<i>Policia Bajram Curri</i>		<i>Bajram Curri</i>	<i>Bajram Curri</i>	
11 0	<i>Policia Rreshen</i>		<i>Diber</i>	<i>Rreshen</i>	
11 1	<i>Policia Puke</i>		<i>Shkoder</i>	<i>Puke</i>	
11 2	<i>Policia Kavaje</i>		<i>Kavaje</i>	<i>Kavaje</i>	
11 3	<i>Policia Sarande</i>		<i>Sarande</i>	<i>Sarande</i>	
11 4	<i>Bashkia Kruje</i>		<i>Kruje</i>	<i>Kruje</i>	
11 5	<i>Bashkia Peqin</i>		<i>Elbasan</i>	<i>Peqin</i>	
11 6	<i>Bashkia Erseke</i>		<i>Korce</i>	<i>Erseke</i>	
11 7	<i>Corovode, Skrapar</i>		<i>Berat</i>	<i>Corovode</i>	
11 8	<i>Bashkia Kucove</i>		<i>Berat</i>	<i>Kucove</i>	
11 9	<i>Bashkia Rreshen</i>		<i>Lezhe</i>	<i>Rreshen</i>	
12 0	<i>Bashkia Ballsh</i>		<i>Fier</i>	<i>Ballsh</i>	
12 1	<i>KONISPOL</i>		<i>Sarande</i>	<i>Sarande</i>	
12 2	<i>Komuna Kashar</i>		<i>Tirane</i>	<i>Kashar</i>	
12 3	<i>Komuna Shenkoll</i>		<i>Lezhe</i>	<i>Shenkoll</i>	
12 4	<i>Komuna Bushat</i>		<i>Shkoder</i>	<i>Bushat</i>	
12 5	<i>Komuna Postribe</i>		<i>Shkoder</i>	<i>Postribe</i>	
12 6	<i>Komuna Maqellare</i>		<i>Diber</i>	<i>Peshkopi</i>	



12 7	<i>Komuna Qukes</i>		<i>Librazhd</i>	<i>Qukes</i>	
12 8	<i>Komuna PUSTEC</i>		<i>Korce</i>	<i>Korce</i>	
12 9	<i>Komuna MAMINAS</i>		<i>Tirane</i>	<i>Tirane</i>	
13 0	<i>Komuna LESKOVIK</i>		<i>Korce</i>	<i>Korce</i>	
13 1	<i>Komuna HORE-VRANISHT</i>		<i>Vlore</i>	<i>Vlore</i>	
13 2	<i>Cakran</i>		<i>Fier</i>	<i>Kashar</i>	
13 3	<i>Qender – Bulgarec</i>		<i>Korce</i>	<i>Korce</i>	
13 4	<i>Vreshtas</i>		<i>Korce</i>	<i>Korce</i>	
13 5	<i>Bashkia Pogradec</i>		<i>Korce</i>	<i>Korce</i>	
13 6	<i>Komuna Bucimas</i>		<i>Korce</i>	<i>Korce</i>	
13 7	<i>Bilisht, Devoll</i>		<i>Korce</i>	<i>Korce</i>	
13 8	<i>Komuna Fier Shegan</i>		<i>Fier</i>	<i>Fier</i>	
13 9	<i>Komuna Ksamil</i>		<i>Sarande</i>	<i>Ksamil</i>	
14 0	<i>Bashkia Gjirokaster</i>		<i>Gjirokaster</i>	<i>Gjirokaster</i>	
14 1	<i>Bashkia Tepelene</i>		<i>Tepelene</i>	<i>Tepelene</i>	
14 2	<i>DROPULL I POSHTEM</i>		<i>Gjirokaster</i>	<i>Gjirokaster</i>	
14 3	<i>DROPULL I SIPERM</i>		<i>Gjirokaster</i>	<i>Gjirokaster</i>	

*Table 1 Zytrat e Aplikimit*

*Kriteret Teknike per sherbim Data per Zytrat e Aplikimit :*

- *Komunikim Sherbim Data ne Rrjet Privat me Zytrat Qendrore te Identitek*
- *Lidhje e Dedikuar Primare me Fiber Optike deri ne Rack Kabinet vetem per zytrat e aplikimit te identitek*
- *Lidhje e Dedikuar Back up 4G/LTE qe vijon te njejtin vlan Sherbim Data*
- *Terminimi ne Zytrat e aplikimit te behet me:*
  - *4GE/LTE SFP Router Sëitch dhe duhet te mundesohen nga Ofruesi*

- Konfigurimi duhet te jete Ean redundant me Primar Fiber Optic / Backup Sim GSM me Vlan te dedikuar sherbim data
- Menaxhim dhe Monitorim te qendersuar te Routerave
  - Kapacitet Simetrik Donëload dhe Upload duke filluar Minimalisht 20 Mbps / 20 Mbps dhe sa me shume kapacitet aq me i preferueshem
  - Disponueshmeri larte CIR 99,5 %.
  - Trafiku Sherbim Data duhet te jete pa limit
  - Te Suportoje dhe te garantoje teknologjine - IPsec VPN
  - Te Suportoje dhe te garantoje Mekanizimin - Mac Filter (Bllokimin e Aksesit per Stacione Aplikimi te pa Autorizuara)

*Kritere Funksionale per Ofruesin e Sherbimit :*

- Te mundesoje Platforme Menaxhimi dhe Sistem Kontrolli te qendersuar per Routerat e zyrave te aplikimit
- Te plotesoje kerkesat e reja per Sherbim Data per Zyrat Aplikimit
- Te garantoje kerkesat per relokim te zyrave egzistuese apo dhe te reja te aplikimit
- Te garantoje stokun e mjaftueshem me routera per gjate gjithe vlefshmerise se sherbimit.
- Te gjithe routerat te jete te te njejtit vendor dhe te jene te certifikuar dhe me specifikimet teknike si me poshte :

*Certifikim*

*Health EN 62311 Safety EN 60950 - 1+A11+A1+A12 EN 301-489-1/-7/-17/-24 EN 55022, EN 55024 EN 301 511 EN 301 908-1/-2 EN 300 328 EMC Radio*

<i>Ethernet Standard</i>	<i>IEEE 802.3</i> <i>IEEE 802.3u</i> <i>AP, Client, Bridge Mode Support</i> <i>EEP, EPA and EPA2 encryption eith AES-TKIP</i> <i>IEEE 802.11ac Optional 5GHz E-i-Fi support</i> <i>SSID Insulation Support</i> <i>Channel management support</i> <i>20MHz / 40MHz /80MHz Beamer support</i>
--------------------------	--

<i>Status Indications</i>	<p><i>SFP: Status Indicator</i></p> <p><i>NET: Connection Setup</i></p> <p><i>ËLAN: Ëireless LAN Connection</i></p> <p><i>ËAN: Ëide Area Netëork Cable Connection Status</i></p> <p><i>LAN: Local Area Cable Connection Status (Lan1 ~ Lan4)</i></p> <p><i>POËER: Poëer Status</i></p> <p><i>VPN: Connection Status Indicator</i></p> <p><i>ËPS: Clear Ëifi Connectivity Indicator</i></p> <p><i>VoIP: IP phone connection indicator</i></p>
<i>Cellular Specifications</i>	<p><i>LTE 800/900/1800/2100/2600 MHz</i></p> <p><i>UMTS/HSPA+900/2100MHz</i></p> <p><i>GSM/GPRS 900/1800/1900 MHz</i></p> <p><i>HSPA+/HSUPA/HSDPA/ËCDMA/UMTS 2100/1900/900/850/800MHz</i></p> <p><i>EDGE/GPRS/GSM 1900/1800/900/850 MHz</i></p> <p><i>HSUPA/HSDPA/UMTS 2100/1900/900/850 MHz</i></p> <p><i>EDGE/GPRS/GSM 1900/1800/900/850 MHz</i></p> <p><i>CDMA 2000/EVDO Rev.A 800MHz</i></p> <p><i>SINGLE SIM/SINGLE GSM MODULE (1x IMEI)</i></p>
<i>Interfaces</i>	<p><i>Minimalisht ose me shume 4x10 / 100/1000 Mb LAN Port</i></p> <p><i>1x10 / 100/1000 Mb ËAN Port</i></p> <p><i>1x10 / 100/1000 Mb SFP Port</i></p> <p><i>1xStandard DC Poëer Input Port</i></p> <p><i>1xUSB Input Port</i></p>
<i>Others</i>	<p><i>Operating Temperature: 0 °C - 40 °C</i></p> <p><i>Dimension: 240mm x 150mm x 35mm Ëeight: 392gr.</i></p>

	<i>Specifikimet Funktionale</i>
--	---------------------------------

<i>Firewall &amp; Filtering</i>	<i>IP packet / Domain / MAC Filter</i> <i>NAT</i> <i>DMZ</i> <i>Protocol Type Check</i> <i>Port Control</i> <i>VLAN Tagging</i>
<i>VPN</i>	<i>IPsec</i> <i>PPTP server</i> <i>L2TP server</i>
<i>Routing</i>	<i>Static Routing, Regulatory Routing, Port Routing</i> <i>RIPv2 / OSPF Dynamic Routing</i>
<i>Poëer Supply</i>	<i>9 ~24VDC</i>
<i>Management</i>	<i>Web Browser ( local / remote) (IE v8 or above)</i> <i>CLI/Telnet M2M</i> <i>Management</i> <i>SSH</i>
<i>Data Features</i>	<i>QoS: Speed limitation, packet prioritization</i> <i>IPv4 / IPv6, TCP / IP, UDP, RTP, SNTP, NAT, DNS, DDNS</i> <i>Address management: Static, DHCP Server, IP / MAC</i> <i>connector, DHCP switching</i>
<i>Poëer Consumption</i>	<i>Idle: 12V / 1A</i> <i>Single Module Poëer Consumption: &lt;5W</i>
	<i>Optionet e Pajisjes</i>
<i>Multiple Working Modes</i>	<i>Led monitor</i> <i>WEB, CLI, SSH, multi-parameter management support</i> <i>Data trigger online/offline</i> <i>LCP/ICMP/flood/availability signal control, network availability</i>

<p><i>Easy Maintenance Operation</i></p>	<p><i>Local/remote firmëare and patch upgrade support</i></p> <p><i>Parameter backup and retrieval support, encryption support</i></p> <p><i>CFE firmëare update support</i></p> <p><i>Smart sëitch support ëhen using multiple servers</i></p> <p><i>Local/remote system logging for easy debugging</i></p>
<p><i>Full Netëork Mode</i></p>	<p><i>ËAN, ËLAN</i></p> <p><i>ËLAN AP/Station/Repeater, 802.11n 2.4GHz up to 300 Mbps 4 LAN ports,</i></p> <p><i>Support Fiber SFP</i></p> <p><i>ËAN support ADSL (PPPoE), static IP, DHCP client</i></p> <p><i>802.11b/g/n optional Ëi-Fi, ËPS sëitch</i></p> <p><i>DNS proxy and Dynamic DNS (DDNS) support</i></p>

*Table 2 Specifikimet Teknike per Routerat e Zyrave te Aplikimit*

**Afati kohor i Implementimit – Brenda 30 (tridhjetë) diteve nga nënshkrimi i kontratës.**

III.1.2. Në shtojcën 6 “Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit”, të dokumenteve të tenderit, rezulton se ëshët kërkuar si vijon:

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet:**

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Afati 3 Vite</b>
<b>1</b>	<i>Sherbim Internet + Data për Zyrën Qendore</i>	<i>zyrë</i>	<i>1</i>	
<b>2</b>	<i>Sherbim Data për Zyra Aplikimi në Tiranë dhe Rrethe</i>	<i>zyrë</i>	<i>143</i>	

**Afatet e ekzekutimit:** *Do të jetë nga momenti i nënshkrimit të kontratës/kontratave, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, brenda afatit 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga lidhja e Marrëveshjes Kuadër.*

Ndërsa në shtojcën 7 “Formulari i termave të referencës”, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar shprehimisht:

**Shtojca 7**

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

## **FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

**Objekti i shërbimeve:**

**Lidhja me fibra optike**

*Ofruesi do të sigurojë lidhjen midis Identitek dhe rrjetit të tij duke përdorur teknologjinë e fibrave optike. Lidhja do të mbrohet, duke krijuar lidhje nga dy pika të ndryshme prezence.*

*Të dyja lidhjet do të realizohen nga pika në pikë nga pika e pranisë së ofruesit në ambientet e Identitek. Lidhja e parë do të qëndrojë aktive gjatë gjithë kohës dhe në rast problemesh lidhja do të kalojë në linjë gatishmërie. Kalimi nga linja aktive në linjën e gatishmërisë do të bëhet në mënyrë automatike duke përdorur pajisjen e demarkacionit të operatorit Ethernet RAD-ETX me dy në rrjedhën e sipërme nga faqja e klientit brenda dhe Sëitch Cisco Metro Ethernet në anën e ofruesit. Linja do të jetë e dedikuar vetëm për Identitek dhe do të jetë në monitorim nga Sistemet tona të Menaxhimit të Rrjetit, duke siguruar mbështetje në rast defektesh.*

**Linje e Dedikuar e Internetit ne Zyren Qendrore**

*Identitek kërkon shërbim interneti të dedikuar dhe me kapacitet Donëload dhe Upload Simetrik 300 Mbps / 300 Mbps, me CIR 99,5 %. Linja do të jetë e dedikuar vetëm për klientin dhe do të jetë në monitorim nga Sistemet të Menaxhimit të Rrjetit, duke siguruar një cilësi shërbimi SLA (Service Level Agreement) dhe mbështetje proaktive në rast degradimi apo defektesh.*

*Për të mundësuar lidhjen ofruesi do të sigurojë lidhjen midis Identitek dhe rrjetit të tij duke përdorur teknologjinë e fibrave optike. Lidhja do të mbrohet, duke krijuar lidhje nga dy pika të ndryshme prezence (PoP).*

*Të dyja lidhjet do të realizohen nga pika në pikë nga pika e pranisë së ofruesit në ambientet e Identitek por në drejtime të ndryshme duke garantuar kështu disponueshmerine në rast defektesh apo demtimesh fizike. Lidhja e parë do të qëndrojë aktive gjatë gjithë kohës dhe në rast problemesh lidhja e dyte do të kalojë në linjë aktive. Kalimi nga linja aktive në linjën e gatishmërisë do të bëhet në mënyrë automatike duke përdorur pajisjen sëitch inteligjent të menaxhueshem të operatorit.*

**Vendi i kryerjes së shërbimit:** Në ambientet e zyrave qendrore të “IdentiTek” SHA dhe zyrave të rretheve.”

III.1.3. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, KPP konstaton, se për sqarimin e fakteve dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, të papranuara nga autoriteti kontraktor, KPP për një gjykim të drejtë dhe transparent të ankesës, vlerësoi të kryhet seancë dëgjimore me përfaqësues të operatorit ekonomik ankimues dhe autoritetit kontraktor. Kjo seancë u mbajt në datën 05.12.2023, ora 13.30, në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, ku prezent ishin përfaqësues të operatorit ekonomik ankimues, përfaqësues të autoritetit kontraktor dhe anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.5. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.6. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

*“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

*Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

*c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

*ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

*5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

*6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet*



*ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor*

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36, pika 1, paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose

përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksional sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*

Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet *“Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”*

Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin

produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mberëtëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mberëtëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të parashtrojnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” është përafëruar pjesërisht edhe me *Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar*. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): “Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik *onus*

*probandi incubit actor* (barra e provës i bie kërkuesit), si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “*në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë, se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtar me reputacion. Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, nënvizon, se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit duhet t’i përmbahet *stricto-sensu* vetëm metodave të parashikuara në nenin 36 të ligjit për prokurimin publik. Ato duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Komisioni gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.1.8. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në marrjen e vendimeve mban parasysht, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efijçencën, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.*”, Komisioni, në jurisprudencën e tij, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar, dhe për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, dhe ligjor për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Ndaj për këtë qëllim, Komisioni organizoi një seancë dëgjimore mes palëve në lidhje me treguesit teknike, të parashikuara në dokumentat e tenderit. Gjatë seancës në pyetjet drejtuar autoritetit kontraktor, Komisioni gjykoi të nevojshëm sqarimin si mbi metodën e ndërtimit të specifikimeve teknike, por edhe në drejtim të rolit në funksionalitetin të teknologjive dhe pajisjeve të kërkuara si dhe në pyetjet drejtuar autoritetit kontraktor, Komisioni gjykoi të nevojshëm sqarimin si mbi metodën e ndërtimit të specifikimeve teknike, por edhe në drejtim të rolit në funksionalitetin e shërbimit dhe pajisjeve prej specifikimeve teknike të cilat pretendohen nga ankuesi se janë hartuar në kundërshtim me

ligjin për prokurimin publik. Gjithashtu, për ankuesin u drejtuan pyetje në drejtim të provueshmërisë së faktit, se përse specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik dhe se si këto të fundit mund të ndikojnë në kufizimin e konkurrencës.

III.1.9. Lidhur kërkesën e autoritetit kontraktor për Lidhjen e Dedikuar Back up 4G/LTE, ankimuesi pretendon se: *“ky kriter është përjashtues për të gjitha kompanitë, pasi dihet publikisht që vetëm dy kompani janë të licencuara për këtë lloj shërbimi. Kemi 10 vite që ofrojmë shërbimin e komunikimit të zyrave të ALEAT sot Itentitek, dhe shërbimi është ofruar nëpërmjet fibrës optike dhe lidhjeve satelitore, ku shërbimi terminohet brenda Shqipërisë, pasi dhe HUB Satelitor është instaluar në ambientet e Albanian Satellite Communications, si dhe disponojmë dhe autorizim të posacëm nga AKEP për ofrimin e këtij shërbimi. Referuar dhe negociimit të kryer për këtë shërbim, i referohemi shërbimit satelitor, ndërsa në procedurën e re kërkohet karta sim 4G. Ky kriter duhet të ndryshohet nga Karta sim 4G në linjë satelitore.”* Në përgjigjen e dhënë ankimuesit nëpërmjet shkresës me nr. 449/11 prot., datë 16.11.2023, autoriteti kontraktor nuk i pranon pretendimet e ankimuesit, duke argumentuar si vijon: *“...Është hequr shërbimi satelitor në kuadër të përmirësimit të cilësisë së shërbimit, gjatë 3 mujorit të fundit janë hasur shumë problematika në lidhje me zyrat e aplikimit kryesisht në rrethe dhe që janë me shërbim satelito. Nga ana e grupit të punës u bë një vlerësim i teknologjisë satelitore dhe teknologjisë 4G si më poshtë:*

<i>Karakteristika</i>	<i>Fiber Optike</i>	<i>Teknologjia 4G</i>	<i>Teknologjia Satelitore</i>
<i>Shpejtësia</i>	<i>Ok</i>	<i>Ok</i>	<i>X</i>
<i>Vonesa</i>	<i>Ok</i>	<i>Ok</i>	<i>X</i>
<i>Faktori Atmosferik</i>	<i>Nuk ndikon</i>	<i>Ndikon</i>	<i>Ndikon</i>
<i>Disponueshmëria</i>	<i>Ok</i>	<i>Ok</i>	<i>Ok</i>
<i>Besueshmëria</i>	<i>Ok</i>	<i>Ok</i>	<i>X</i>
<i>Stabiliteti</i>	<i>Ok</i>	<i>Ok</i>	<i>X</i>

*Shënim: OK- plotëson pritshmëritë e autoritetit, X-nuk plotëson pritshmëritë e autoritetit.*

*Rezultantja: Teknologjia 4G e përmbush brezin e gjerë të pritshmërive për faktor dhe për këtë arsye është vendosur si BACKUP, ndërsa teknologjia satelitore përmbush vetëm faktorin e disponueshmërisë dhe për këtë arsye nuk u konsiderua.*

*AK përgjigje: Për rastin e linje primare kërkohet që OE të zotërojë infrastrukturën e transmetimit, ndërsa për linjën back up nuk shtë e detyrueshme të zotërohet nga OE, ai mund ta sigurojë atë nëpërmjet ofertuesve të tjerë. Në rastin tonë bëhet fjalë për shërbimin e transmetimit të të dhënave nga ana e zyrave qendrore dhe zyrave në rrethe, kështu që pohimi se “janë vendosur kriteret që i përkasin një prodhuesi të caktuar” është i pavlefshëm. Shërbimi i kërkuar është i kompozuar dhe i ndërlidhur me thyerje teknologjike për të arritur maksimumin e të dy faktorëve teknologjikë për të siguruar të njëjtën cilësi shërbimi të përsosur dhe OE mund ta sigurojë atë përmes ofertuesve të tjerë në treg. Nqs nuk do konsiderohej si kriter cilësia e shërbimit dhe do të vendosim si back up transmetimin*

*satelitor do të siguronim avantazh dhe kritere drejt një provideri të caktuar me konkretisht drejt OE i cili ka depozituar ankesë.*

*Këto të dhëna fakte janë të njohur botërisht. Për këtë arsye grupi i punës futi në studim tregu teknologjinë 4G dhe të gjithë OE që kanë ofertuar e kanë përfshirë në zgjidhjen teknike të ofruar pa komente apo mangësi.*

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere/specifikime që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. KPP gjykon, se sa më sipër arsyetuar, në lidhje me mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike, ritheksojmë se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, si dhe të mos shërbejnë si pengesa për pjesëmarrjen e të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në një procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, si dhe argumenteve të autoritetit kontraktor, Komisioni gjykon, se përcaktimi në mënyrë eksplicite i teknologjisë 4G, e kufizon konkurrencën në mënyrë të panevojshme, është kërkesë e ekzagjeruar dhe nuk i shërben qëllimit për të cilin kërkohet përdorimi i tij. Pyetjes së Komisionit të Prokurimit Publik, drejtuar autoritetit kontraktor në seancën dëgjimore se në bazë të cilave metodave, standardeve kombëtare apo ndërkombëtare, apo terma funksionale është mbështetur në hartimin e specifikimeve teknike të pajisjeve dhe shërbimeve të kërkuara, pra si ka arritur në këto konkluzione në hartimin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike, nga ky i fundit u sqarua, se AK është bazuar mbi kërkesat funksionale, mbi rekomandimet e AKCESK, si dhe mbi standardet e industrisë që janë për rrjetin dhe komunikimin e të dhënave sensitive, pra ndyshimi i teknologjisë cenon funksionalitetin e shërbimit. Në këtë seancë u pohua nga të dyja palët se të gjitha teknologjitë paraqesin rrisht, por në asnjë rast nuk është argumentuar me tregues konkrete si cenohet ky funksionalitet në parashikimin e shërbimit 4G, duke përjashtuar shërbime të tjera ekuivalente. Referuar sqarimeve të dhëna në seancën dëgjimore nga përfaqësuesit e operatorit ekonomik dhe përfaqësuesit e autoritetit kontraktor rezultoi se shoqëri ankimuese aktualisht është zbatuese e kontratës në fjalë, të cilën e realizon me një teknologji të ndryshme nga teknologjia 4G si dhe u pohua fakti, se nuk ka asnjë shkelje të kushteve të kontratës, e cila të jetë e evidentuar.

Komisioni gjykon, se për autoritetin kontraktor nuk është e rëndësishme teknologjia që do të përdoret, por rezultati i funksionimit, të cilat mund të arrihen edhe me teknologji të tjera nga ajo 4G. Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor, gjatë seancës dëgjimore, nuk ka

argumentuar apo provuar as ligjërisht, as teknikisht, se kërkesa për teknologjinë 4G, nuk e kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe pse ky specifikim teknik nuk i drejton operatorët ekonomikë pjesëmarrës vetëm drejt një ose dy kompanive dhe se ndryshimi i tyre ndikon në funksionalitetin e shërbimit dhe në qëllimin e përdorimit të tij. Në këto kushte, me qëllim hapjen e diapazonit të zgjidhjeve të propozuara, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të modifikojë specifikimet teknike të mësipërme, duke lejuar alternativa të tjera të cilat realizojnë të njëjtin funksionalitet.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.1.10. Lidhur me pretendimet e ankimuesit përsa i përket kërkesave teknike të autoritetit kontraktor për ruterat, në përgjigjen e dhënë ankimuesit nëpërmjet shkresës me nr. 449/11 prot., datë 16.11.2023, autoriteti kontraktor nuk i pranon pretendimet e ankimuesit, duke argumentuar si vijon: *“Pajisjet (routerat) janë aktorët kryesore që duhet të lejojnë dhe plotësojnë funksionet përkatës të komunikimit, vërtetimit, procesimit të regjistrimit dhe përpunimit të identitetit në mënyrë të përsosur. Vlen të theksohet se këto janë kërkesa minimale dhe cdo gjë tjetër mbi to është e pranueshme. [...] Natyra e kërkesës është si shërbim dhe jo si blerje paisjes. Specifikimet teknike për routera janë venosur për të garantuar shërbim të përsosur dhe janë kërkuar të një brandi të vetëm për të unifikuar teknologjinë. Në këtë formë AK trajnon stafin për një teknologji të caktuar dhe është me eficiente në raport me kostot. Specifikimet teknike janë të natyrës minimale dhe cdo gjë tjetër mbi to është e pranueshme.”*

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për procedurën e prokurimit, ka përgjegjësi të përcaktojë kritere tregues teknike që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në seancën dëgjimore përfaqësuesi i autoritetit kontraktor u shpreh se në hartimin e specifikimeve teknike të ruterave është synuar të arrihet një shërbim i përsosur dhe të mos cojnë në orientim drejt një subjekti të vetëm. Konstatimin se për oferten teknike, specifikimet teknike të ruterave janë dhënë të detajuara fikse për sa i përket madhësisë, vëllimit me dimensione konkrete fizike, autoriteti kontraktor ka sqaruar se dimensionet janë vendosur pasi ka veshitur për vendosjen e tyre në strukturat ekzistuese, por këto tregues nuk janë thelbësorë dhe janë minimal, nëse ofrohen të përmirësuara janë të mirepritura, pasi në thelb nuk synohet të arrihet blerja e pajisjeve, por sigurimi i shërbimit objekt - prokurimi.

Në rastin konkret, autoriteti kontraktor, në lidhje me kërkesat e mësipërme për ruterat ka kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të cilët mund të ofrojnë produkte me një specifikime të tjera, por pa ndikuar në cilësinë dhe funksionalitetin e tij. Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor, gjatë seancës dëgjimore, nuk ka argumentuar apo provuar as ligjërisht, as teknikisht, se specifikimet e hartuara prej tij nuk e kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe pse këto specifikime teknike nuk i drejtojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës vetëm drejt një prodhuesi dhe se ndryshimi i tyre ndikon në funksionalitetin e pajisjes dhe në qëllimin e përdorimit të saj. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht, se si ndikojnë këto specifikime teknike në funksionalitetin e pajisjeve. Gjithashtu rezulton, se autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar, se në cilat standarde kombëtare apo ndërkombëtare është bazuar në hartimin e këtyre specifikimeve

teknike, referuar nenit 36 të LPP-së. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces. Sa më sipër, KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh, me qëllim përfitimin e një produkti me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë, se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë parametra teknike kufizues e përjashtues, por duhet të përcaktojë parametra minimalë dhe me diapazon të gjerë, duke përdorur një minimum dhe një maksimum të parametrave, në mënyrë që të rritet konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomikë, me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në dokumentacionin e depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar, se në cilat standarde kombëtare apo ndërkombëtare është bazuar në hartimin e këtyre specifikimeve teknike, referuar nenit 36 të LPP-së.

KPP thekson, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, si dhe të kërkojë që produktet objekt-prokurimi të jenë të cilësisë maksimale, por nuk mund të kufizojë konkurrencën, duke vendosur specifikime teknike të cilat nuk arrin t’i justifikojë me argumente konkrete dhe shkencore. Specifikimet teknike duhet të përcaktohen të qarta dhe të sakta nga autoriteti kontraktor, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

Në këto kushte, me qëllim hapjen e diapazonit të zgjidhjeve të propozuara, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të modifikojë specifikimet teknike të mësipërme, duke i hartuar ato bazuar në funksionalitetin që kërkohet, pa përcaktuar parametra fikse, por duke pasur parasysh se këto specifikime nuk duhet të cenojnë funksionalitetin e pajisjes.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.1.11. Lidhur me pretendimit e operatorit ekonomik ankimues se: **“Në kërkesat teknike është kërkuar: Ofruesi duhet te marri sherbimin nga minimalisht 2 ISP Tier 1; Ofruesi duhet te jete minimalisht Tier 2”**. Ky kriter nuk është aplikuar në asnjë procedurë prokuruese për shërbim interneti dhe data deri me sot. AK duhet të referohet tek KVK e AKSHI si Agjenci e vetme shtetërore që ofron shërbime dhe prokuron për të gjitha institucionet shtetërore. Në procedura analoge AKSHI ka kërkuar: “Numri aktual “Peer” që operatori duhet të disponojë si Uplink për daljen e tij në internet nuk duhet të jetë më i vogël se 5, ku nga këto 5 duhet të ketë të paktën 2 “Peers” me provider AS të regjistruar jashtë territorit të Shqipërisë. Shërbimi me secilin prej 5 operatorëve duhet të dëshmohet



*me anë të kontratës përkatëse si edhe të jetë i verifikueshëm nëpërmjet Databazës së “RIPE NCC”. Kërkojmë që ky kriter të zëvendësohet sipas versionit të AKSHI-t”, në përgjigjen e dhënë ankimuesit, autoriteti kontraktor i ka refuzuar pretendimet e tij me argumentet se: “Në industrinë e Ofruesve të Shërbimeve të Internetit (ISP), TERMAT “Tier-1”, “Tier-2” dhe “Tier-3” përdoren për të klasifikuar ISP-të, bazuar në nivelin e shërbimit që ofrojnë dhe infrastrukturën që ata përdorin. ISP-të e nivelit 1 ose Tier 1 janë ISP-të më të mëdhenj dhe më të rëndësishëm në infrastrukturën globale të internetit. Ata janë përgjegjës për sigurimin e bazës së internetit dhe lidhjen e ISP-ve të tjera me internetin global. ISP-të e nivelit 1 zakonisht nuk ofrojnë shërbime drejtpërdrejt për përdoruesit fundorë, por më tepër shesin gjerësinë e brezit dhe kapacitet me sasi tek ISP-të e tjera. ISP-të e nivelit 2 ose Tier 2 janë më të vegjël se ISP-të e nivelit 1 dhe zakonisht janë ofrues rajonalë ose kombëtarë që i shërbejnë një zonë specifike gjeografike. Ata mund të blejnë gjerësi brezi me sasi nga ISP-të e nivelit 1 dhe t’ua rishesin atë ISP-ve të tjerë ose Institucioneve Qeveritare apo të rëndësishme të vecantë ose kompanive të mëdha. ISP-të e nivelit 3 ose Tier 3 janë më të vegjël se ISP-të e nivelit 2 dhe zakonisht janë ofrues lokalë që i shërbejnë një komuniteti ose zone specifike lokale. Ata mund të blejnë gjerësi brezi me sasi nga ISP-të e nivelit 2 dhe t’ua rishesin atë përdoruesve fundorë ose mund t’u ofrojnë shërbime drejtpërdrejtë përdoruesve fundorë. Bazuar në këto standarde të cilat janë të njohur botërisht, grupi i punës futi në studim tregu Tier 1 dhe Tier 2 ISP, për të garantuar shërbimin kritik kundrejt institucioneve qeveritare apo të rëndësishme të vecantë si është dhe autoriteti kontraktor”.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në Komisionin e Prokurimit Publik, argumenteve të dhëna në seancën dëgjimore nga të dyja palët, si dhe nga shqyrtimi i specifikimeve teknike dhe termave të referencës, konstatohet, se kërkesa e autoritetit kontraktor për Tier 1 dhe Tier 2, në asnjë rast nuk është argumentuar teknikisht nga ana e autoritetit kontraktor. Gjithashtu, autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë argument dhe nuk ka justifikuar, se në cilat standarde është mbështetur në parashikimin e tyre. Akoma më tej këmi të bëjmë me një shërbim që i nënshtrohet procesit të licencimit sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi dhe në seancën dëgjimore të mbajtur për këtë qëllim, nga të dyja palët, si nga ana e operatorit ekonomik ankimues ashtu edhe nga përfaqësuesit e autoritetit kontraktor nuk u evidentua asnjë rast që kërkesa për Tier 1 dhe Tier 2 është kusht për licencim.

KPP thekson, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktet dhe shërbimet e kërkuara, por nuk mund të kufizojë konkurrencën, duke vendosur kërkesa teknike të cilat nuk arrin t’i justifikojë me argumente konkrete dhe shkencore. Specifikimet teknike duhet të përcaktohen të qarta dhe të sakta nga autoriteti kontraktor, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

*rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

### **Vendosi**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albanian Satellite Communications” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-86052-11-01-2023, me objekt: “*Shërbim Netëorku për Trasmelimin e të Dhënave midis Zyrës Qendrore dhe Zyrave në Rrethe*”, me fond limit 98,201,100 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, “IdentiTek” SHA.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet e dokumenteve të tenderit në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Albanian Satellite Communications” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**